



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "BRT" Sh.P.K. të datës 08.04.2023 kundër B58 njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 06.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i pushimores në Banjë të Istogut" me nr. të prokurimit 616-23-594-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "BRT" Sh.P.K. e datës 08.04.2023 kundër B58 njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 06.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i pushimores në Banjë të Istogut" me nr. të prokurimit 616-23-594-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues për nënshkrim të kontratës duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën hyn në fuqi ky vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "BRT" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "BRT" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 08.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër B58 njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues rivlerësim të datës 06.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i pushimores në Banjë të Istogut" me nr. të prokurimit 616-23-594-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimi i parashtruesit është i cituar si në vijim:** *“Kompania jone BRT Sh.P.K ka kontrate aktive per vendpunishten ne fjale te cilen e gjeni te bashkangjitur ne attach dhe nuk mendojm qe ka qene e drejt nga ana e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtines qe te beje njoftim per kontrate per pune shtese ne te cilat ne veq jemi duke punuar, duke e ditur sa problemet kan qene gjate implementimit te kontrates per te cilat menagjeri i kontrates eshte ne dijani dhe jane kryer edhe pune shtese per te cilat asnjeher skemi pranuar pagese, dhe me gjithë respektin ne nuk do te pranojm qe punet te cilat veq jane punuar te na nderhyje operator tjetër. Shpresojm te kem in nje sqarim nga ana juaj”*.

Parashtruesi nuk ka paraqitur se cilat dispozita të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje si “LPP”) apo të legjislacionit sekondar mund të jenë shkelur në këtë rast.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- Njoftimi për kontratë i datës 03.02.2023;
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i datës 07.03.2023;
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 06.04.2023;
- Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 22.11.2021 në kuadër të aktivitetit të prokurimit me nr. të prok. 616-21-6690-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 21 140 521

Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 19.04.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimin e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohet pretendimi i parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nënparagrafi d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”) sipas elaborimeve në vijim.

Fillimisht duhet cekur se pretendimi i parashtruesit nuk është formuluar në mënyrë të kuptueshme dhe konkrete. Kjo pasi që parashtruesi në emër të pretendimit të kërkesës për rishqyrtim, nuk ka paraqitur konstatimin e tij për shkeljet eventuale gjatë procedurës mirëpo vetëm ka shprehur pranë autoriteti kontraktues mospajtimin lidhur me zhvillimin e kësaj procedure të prokurimit me pretekstin se punët që synohen të kryhet me këtë aktivitet të prokurimit janë të njëjta me punët që ka kryer parashtruesi përmes një kontrate tjetër aktive që është lidhur ndërmjet atij si operator ekonomik dhe Komunës së Prishtinës së Autoritet Kontraktues. Megjithatë gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se kontrata aktive ku është palë parashtruesi dhe procedura e prokurimit për të cilën është paraqitur kërkesa për rishqyrtim, janë dy aktivitete të ndara të prokurimit me qëllime dhe aktivitete tërësisht të ndryshme. Si të tilla këto dy aktivitete të prokurimit në asnjë mënyrë nuk manifestojnë kryerjen e punëve të njëjta sikurse që pretendon parashtruesi. Më konkretisht, parashtruesi është palë kontraktuese në aktivitetin e prokurimit me nr. të prokurimit 616-21-6690-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 21 140 521. Kontrata e lidhur në këtë rast ka për objekt kontraktues kryerjen e punëve tërësisht të tjera nga punët që synohen të kryhen përmes kontratës që do të lidhet në kuadër të procedurës së prokurimit për të cilën është paraqitur kërkesa për rishqyrtim.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 19.04.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.